



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 13 Prot

Tiranë, më 08.02, 2013

VENDIM Nr. 239, dt. 08.02.2013

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 08.02.2013 pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve HEC Rapun 3 dhe HEC Rapun 4, në zonën e Librazhdit - Subjekti "C&S Energy" sh.p.k., Tiranë,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga **Agjencia e Shërbimit Arkeologjik** për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve "HEC Rapun 3 dhe HEC Rapun 4", në zonën e **Librazhdit**, paraqitur nga Subjekti "**C&S Energy**" sh.p.k., Tiranë.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Tiranë bazuar në kontratën dypalëshe midis "**C&S Energy**" sh.p.k. dhe **Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik**.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori ("**C&S Energy**" sh.p.k.) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Tiranë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
ALDO BUMÇI

MINISTËR  


SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI  


